



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondit për Sigurime Shëndetësore kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- B1 Në 17 raste në vlerë prej 445,649€, kemi vërejtur që lëndët e kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm që nga viti 2021 nuk ishin trajtuar nga Bordi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike.
- B2 Në 20 raste në vlerë totale prej 345,228€, FSSh, ka lëshuar fletëzotime duke u bazuar vetëm në një pro-faturë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Fondit për Sigurime Shëndetësore është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondit për Sigurime Shëndetësore me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit për Sigurime Shëndetësore.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm përfshijnë forcimin e zbatueshmërisë së kontrolleve në lidhje me pajtueshmërinë ndaj autoriteteve, veçanërisht në menaxhimin e obligimeve të papaguara dhe detyrimeve kontigjente.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Vonesa në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me shqyrtimin e lëndëve nga Bordi për lëndët e kompletuara me faturë

#### Gjetja

Udhëzimi Administrativ (UA) 03/2017, për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), si dhe UA 03/2023 për periudhën pas shtatorit 2023, divizioni për TMJISHP kontrollon aplikacionin në lidhje me përmbajtjen dhe korrektësinë e dokumentacionit të bashkangjitur gjatë aplikimit para se të shqyrtohen nga Bordi dhe pas kompletimit të lëndës e dërgon për aprovim në Bord. Bordi duhet të bëjë shqyrtimin dhe të marrë vendimet për lëndët që kërkojnë trajtim mjekësor jashtë institucioneve brenda afateve dhe në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Kemi vërejtur se në 17 raste në vlerë të përbashkët 445,649€, lëndët e kompletuara me faturë, nuk ishin shqyrtuar nga Bordi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike siç kërkohet me procedurë. Një nga këto raste është e kompletuar që nga viti 2021, kurse lëndët tjera ishin kompletuar me fatura që nga muaji shkurt 2024.

Për më shumë, obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar për 28,800€, pasi që një lëndë ishte prezantuar dy herë në regjistrin e obligimeve të papaguara.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mos marrjes së masave të nevojshme nga personat përgjegjës për trajtimin e mëtutjeshëm të këtyre lëndëve. Ndërsa, sipas deklarimit të zyrtarëve, vonesat në shqyrtimin e lëndëve shkaktohen kryesisht nga mos kompletimi i dokumentacionit të kërkuar.

#### Ndikimi

Mos trajtimi i lëndëve kundrejt fletëzotimeve të lëshuara ndikon që Institucionet shëndetësore jopublike mund të hezitojnë në kryerjen e shërbimeve në të ardhmen bazuar vetëm në fletëzotime. Për më shumë, mund ta bëjë FSSH-në subjekt të padive, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

#### Rekomandimi B1

Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që lëndët e kompletuara të trajtohen brenda afatit të përcaktuar. Për rastet tek të cilat ka paqartësi, të ndërmerren hapat e nevojshëm për sqarimin e tyre në mënyrë që të pastrohen regjistrat.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Lëshim i fletëzotimeve në mungesë të aplikacioneve të plota sa i përket profaturave

#### Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 03/2023 të (MSH) për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), neni 4, pika 4.4, kërkohet paraqitja e tri pro-faturave nga institucione shëndetësore të ndryshme, në rastet kur nuk ekzistojnë çmime referente për diagnozat e përcaktuara në këtë udhëzim. Ky rregull zbatohet për rastet e rregullta dhe ato urgjente. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2017, që mbulonte rastet para hyrjes në fuqi të UA të ri, neni 4, pika 3.4, kërkonte paraqitjen e dy pro-faturave nga institucione shëndetësore të ndryshme.

Nga testimi i mostrave kemi vërejtur se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (FSSH), në 20 raste ka lëshuar fletëzotime duke u bazuar në vetëm një pro-faturë. Prej tyre, katër (4) raste me vlerë totale prej 193,000€, i përkasin periudhës pas hyrjes në fuqi të UA në vitin 2023. Ndonëse sipas udhëzimit kërkohet që të paraqiten tre pro-fatura. Ndërsa 16 raste, me vlerë totale prej 152,228€ i përkisnin periudhës sa ishte në fuqi UA-03/2017, megjithëse sipas udhëzimit kërkohet që të bashkëngjiten dy pro-fatura.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme efektive në procesin e lëshimit të fletëzotimeve. Gjithashtu, kufizimi kohor për të lëshuar fletëzotimet për rastet urgjente në afate të caktuara kohore pa ndjekur plotësisht procedurat e parapara.

**Ndikimi**

Lëshimi i fletëzotimeve në mungesë të profaturave shkakton mos pajtueshmëri ligjore dhe mund të ndikojë në çmime më të mëdha të aprovuara për trajtime në mungesë të konkurrencës duke dëmtuar kështu buxhetin e organizatës. Për më shumë kjo mund të ndikoj edhe në vonesa apo mos aprovim për pagesë të atyre lëndëve nga Bordi.

**Rekomandimi B2**

Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë respektimin e plotë të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimet Administrative për procedurat e lëshimit të fletëzotimeve, duke u kujdesur që në të gjitha rastet të jenë të bashkëngjitura dokumentet përkatëse, përfshirë numrin e kërkuar të pro-faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>8,877,671</b>	<b>12,723,112</b>	<b>12,637,057</b>	<b>22,711,153</b>	<b>6,128,439</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	8,877,671	12,723,112	12,637,057	22,711,153	6,128,439

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 3,845,441 €. Ky ndryshim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje, si dhe shkurtime buxhetore.

Në vitin 2024 FSSH ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>8,877,671</b>	<b>12,723,112</b>	<b>12,637,057</b>	<b>22,711,153</b>	<b>6,128,439</b>
Pagat dhe mëditjet	375,854	421,295	421,295	396,198	341,756
Mallrat dhe shërbimet	476,817	276,817	240,543	223,486	187,452
Komunalitë	25,000	25,000	16,685	16,298	16,880
Subvencionet dhe transferet	8,000,000	12,000,000	11,958,533	22,075,171	5,582,351

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin ishte rritur për 45,441€. Realizimi në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 200,000€. Kjo ulje ishte me kërkesë të FSSH-së për transferin e këtyre mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Realizimi i kësaj kategorie ishte 85% e buxhetit final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,000,000€. Kjo rritje ishte rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si dhe të ndarjeve të mjeteve shtesë me vendime të Qeverisë për pagesën e detyrimeve të dala nga lëshimi i fletëzotimeve. Realizimi i subvencioneve ishte 100% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Pranimet e realizuara në vitin 2024 nga FSSH në vlerë 888,603€ ishin nga mjetet e kthyera në buxhetin e Republikës së Kosovës si rezultat i barazimeve të ndodhura me spitalet private për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) në lidhje me pagesat paraprake të pa shpenzuara.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>96,087</b>	<b>96,087</b>	<b>888,603</b>	<b>57,171</b>	<b>128,723</b>
Të hyrat jo tatimore	96,087	96,087		57,171	128,723
Të hyrat tjera	0	0	888,603		

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të FSSH ka rezultuar në pesë (5) rekomandime. FSSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime ishin zbatuar, dhe dy (2) rekomandime nuk kishte filluar zbatimin.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që obligimet të paguhen brenda afatit. Për rastet tek të cilat ka paqartësi, të ndërmerren hapat e nevojshëm për sqarimin e tyre në mënyrë që të pastrohen regjistrat.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2024 ka vonesa në trajtimin e lëndëve.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se fletëzotimet lëshohen vetëm atëherë kur lëndët janë të kompletuara dhe kanë përmbushur kriteret e UA-së.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2024 FSSH kishte lëshuar fletëzotime me një profaturë.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar se regjistrat e pasurive raportohen saktë dhe drejtë në PVF.	Gjatë testimit të mostrave nuk janë hasur raste të tilla.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.	Gjatë vitit 2024 nuk janë hasur raste të tilla.	I zbatuar
5.	Detyrimet Kontigjente	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë se lëndët të cilat i kanë përmbushur kriteret për njohjen si detyrimeve të shqyrtohen në kohë sa më të shkurtër nga ana e Bordit për TMJISHP, të njëjtat të largohen nga regjistrat e detyrimeve kontigjente për t'u prezantuar në regjistrat e detyrimeve të papaguara. Po ashtu, të largohen nga regjistri i detyrimeve kontigjente lëndët të cilat janë paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi.	Gjatë testimit të mostrave nuk janë hasur raste të cilat i kanë përmbushur kriteret për njohjen si detyrimeve e të cilat janë prezantuar në regjistrat e detyrimeve kontigjente.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Burbuqe Idrizi Ukaj, Udhëheqëse e ekipit



Drilon Osmani, Anëtar i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit





## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.